



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.272/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër Isa Agushi për shkak të bërjes presion ndaj votuesve gjatë ditës së votimit në komunën e Gjilanit, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 15.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr.272/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje

## A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje në të cilën theksohet se me datën 11 qershor 2017 aktivistët e Levizjes Vetëvendosje në qendrën e votimit 0409D shkolla fillore “Agim Ramadani” në fshatin Zhegër komuna e Gjilanit, kan konstatuar se kandidati për deputet Isa Agushi ka bërë presion ndaj votuesve afër qendrës së votimit. Sipas parashtruesit të ankesës kjo përbën shkelje te dispozitës se nenit 213 te Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

PZAP-i me datën 13.02.2017 nëpërmjet telefonit zyrtar ne cilësinë e dëshmitarit mori deklaratën e Rrahman Agushit menaxheri i kësaj qendre të votimit i cili e mohon se ka pasur parregullsi apo se dikush ka bërë presion në këtë qendër dhe se sipas tij gjithçka ka shkuar në rregull.

Lidhur me rastin ne fjale PZAP-i e njoftoi edhe Policinë e Kosovës dhe kërkoi nga ata që të ndër marrin veprime konkrete.

Në raportin e policisë të datës 13.06.2017 të dorëzuar në PZAP theksohet se lidhur me rastin në fjale zyrtarët policor me datën 11.06.2017 kanë shkuar në atë lokacion ku kane biseduar me kryetarin e LDK-së Muhadin Haziri lidhur me rastin në fjalë ku i njëjti ka thënë se ndikim në

votim nuk ka ndodhur dhe nuk do të ndodh. Në Raportin Policor theksohet se as pas patrullimit të policisë nuk kane vërejtur ndonjë dyshim rreth ndikimit të vullnetit të lirë tek qytetarët për dhënien e votës, dhe se vendi nga i cili buron ankesa për dyshim (qendra e fshatit Zhegër ) deri tek qendra e votimit që është mbajtur në shkollën Agim Ramadani është rreth 500 metra largësi dhe se lokacioni në fjalë nuk shihet njëra me tjetrën dhe se deri në fund të procesit zgjedhor nuk kane pasur ndonjë ankesë të natyrës së tillë.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar:**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi apo provë materiale e cila do ti vërtetonte pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar pretendimet ankimore. Po ashtu, Paneli vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që as nga raporti policor nuk është vërtetuar se ka pasur veprime të kundërligjshme- presion ndaj votuesve si dhe as nga pala ankuese nuk është ofruar asnjë prove për tu dëshmuar pretendimet në ankesë, andaj në rast se pala ofron prova të reja në kuptim të nenit 118, paragrafi 4 të LPZ-së, PZAP do ta rishqyrton vendimin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 272/2017 më datën 15.06.2017

**Kryesuesi i Panelit**

Rafet Haxhaj



#### ***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*